

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6527  
E premte, 4 shkurt 2022  
çmimi 0.40 €

Aeroporti i Gjakovës,  
në listën e premtimeve  
të papërbushura | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOMITETI PËR KOORDINIMIN DHE VLERËSIMIN E SITUATËS ME PANDEMINË  
COVID-19 KA DHËNË REKOMANDIMET E TIJ

## PROPOZOHET LEHTËSIMI I MASAVE KUNDËR COVIDIT



Qeveria e Kosovës sot (e premte) pritet të marrë vendim për lehtësimin e masave kundër Covidit. Një gjë të tillë e ka propozuar komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës me pandeminë Covid-19 në vend. Masat e reja përfshijnë shtyrjen e orës policore deri në orën 24:00 dhe zgjatjen e orarit të punës për gastronominë deri në orën 23:00. Në ditën e propozimit për zbutje të masave, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se varianti Omicron i koronavirusit vazhdon të përhapet me intensitet të lartë në vend.

**Rama: Çmimi i naftës është rritur kudo, por do ta vazhdojmë rritjen e pagave** | **FAQE 7**



**THAÇI, VESELI, SELIMI DHE KRASNIQI SOT DALIN PARA GJYKATËS SPECIALE**

| **FAQE 3**

### AKTUALE



**PRIJËSIT FETARË NË MAQEDONI TË VERIUT BËJNË THIRRJE PËR VAKSINIM** | **F. 2**

**VLERËSOHET MBËSHTETJA E NALT-IT PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE FSK-në** | **F. 7**

**FUNKSIONIMI I MIRË I QEVERISJES LOKALE, I DOMOSDOSHËM PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE EFIKASE PËR QYTETARËT** | **F. 6**


### EKONOMI



**AGROKOSOVA HOLDING DO TË JETË NËN ADMINISTRIMIN E AKP-së** | **F. 8**

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA 'AFTËSITË PËR TREGUN E PUNËS - FIT FOR JOBS'** | **F. 8**

### SPORT



**CANA, KRENAR ME STRAKOSHËN, LAVDËRON EDHE HYSAJN** | **F. 10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Eskobari dhe Lajçaku takohen me zyrtarët dhe opozitën në Beograd



**BEOGRAD, 3 SHKURT** - Gjatë vizitës në Beograd, Gabriel Escobar dëshiron që të takohet me sa më shumë aktorë politikë serbë, ka njoftuar përmes "Twitter"-it Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në Serbi.

Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit i ShBA-së dhe i dërguari i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe

përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi dhe çështje të tjera rajonale në Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajcak, janë në një vizitë dyditore në Beograd. "BE-ja dhe ShBA-ja janë duke bashkëpunuar ngushtë për realizimin e së ardhmes evropiane të Kosovës dhe Serbisë, si vizioni i tyre i përbashkët, ndërkaq përparimi

për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella është një hap i rëndësishëm", ka shkruar Ambasada Amerikane në një postim në "Twitter".

Pas takimit me kryeministren e Serbisë, Ana Bërnabiq, Escobar dhe Lajcak janë takuar me shefin e diplomacisë serbe, Nikolla Selaković dhe me zyrtarë të tjerë serbë.

## Prijësit fetarë në Maqedoni të Veriut bëjnë thirrje për vaksinim

**SHKUP, 3 SHKURT** - Prijësit fetarë në Maqedoninë e Veriut i kanë bërë thirrje popullatës që të vaksinohet kundër koronavirusit pasi konsiderohet mënyra e vetme për mbrojtjen e shëndetit nga sëmundja Covid-19 dhe për kthimin e vendit në gjendje normale.

Pas takimit me ministrin e Shëndetësisë, Bekim Sali, kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Maqedonase, Stefani tha se kisha që në fillim ka bërë thirrje që të respektohen masat për mbrojtje nga pandemia, por edhe një herë bën thirrje te besimtarët që të mbrohen nga virusi përmes vaksinimit. "Në mesazhet për

festat e mëdha fetare kemi apeluar vazhdimisht që të respektohen masat, sepse është më mirë të parandalohet diçka sesa të shërohet", ka deklaruar kryepeshkopi Stefani.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Shaqir Fetahu, tha se institucioni fetar që ai drejton po u përmbahet rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe rregullave rregulloreve islame për mbrojtjen e besimtarëve nga infektimi me koronavirus. Ai tha se nëpër xhami, në veçanti ditëve të premte, jepen mesazhe për t'i respektuar masat mbrojtëse dhe për t'u vaksinuar. "Në të gjitha

xhamitë në faljet e xhumasë kemi bërë apel që të respektohen masat, por edhe kemi përcjellë mesazhet që besimtarët ta marrin seriozisht vaksinimin", ka thënë Fetahu.

Ministri i Shëndetësisë, Bekim Sali, në takim ka pritur edhe peshkopin e Kishës Katolike, Kiro Stojanov dhe kryetarin e Bashkësisë Hebraike, Pepo Levi. "Në një kohë pandemie, kur të gjithë janë të prekur nga virusi dhe shumë prej nesh kanë humbur njerëz të dashur, dua të bëjë thirrje për vaksinim kundër kësaj murtaje e cila ka ndryshuar mënyrën tonë të jetesës tash e dy vjet. Jam i bindur se kjo është mënyra e vetme për t'u mbrojtur nga



përhapja e virusit, andaj vaksinohuni", ka deklaruar ministri i Shëndetësisë, Bekim Sali.

Vaksinimi në Maqedoninë e

Veriut, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, ende nuk ka arritur në 50 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë dymilionëshe.

## Të paktën 13 persona të vrarë pas operacionit amerikan në Siri



**WASHINGTON, 3 SHKURT** - Forcat speciale amerikane kanë përndjekur xhihadistë të rangut të lartë gjatë bastisjeve në veriperëndim të Sirisë të enjten, duke lënë të vdekur 13 persona. Pentagoni e ka përshkruar këtë operacion si të "suksesshëm". Operacioni besohet se është më i madhi i këtij lloji që kanë kryer forcat amerikane në rajonin Idlib - të kontrolluar nga xhihadistët - prej vitit 2019, kur është vrarë lideri i grupit militant, Shteti Islamik (IS), Abu Bakr al-Baghdadi.

Shënjestrat e operacionit të kryer në qytezën Atme, i cili, sipas

banorëve, ka zgjatur për dy orë, nuk dihen ende.

Disa banorë kanë thënë se forcat amerikane nuk kanë pasur cak operativë të IS-it, por pjesëtarë të grupit xhihadist Al-Kaida. "Operacioni special amerikan, nën kontrollin e Komandës Qendrore të ShBA-së, ka kryer një mision kundër-terrorizmit në veriperëndim të Sirisë. Misioni ka qenë i suksesshëm. Nuk ka viktima", ka thënë Kirby, pa ofruar hollësi shtesë.

Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut ka thënë se shtatë civilë kanë qenë në mesin e 13 personave të vrarë në operacion.

## Zelanda e Re paraqet planin për rihapje të kufijve

Wellington, 3 shkurt - Zelanda e Re ka paraqitur planin për rihapje të kufijve dhe ka nisur t'i shkurttojë kufizimet për luftimin e pandemisë.

Qytetarët e vaksinuar që janë në Australi do të mund të shkojnë në shtëpi nga 27 shkurti, derisa shtetasit e vendeve të tjera do të mund të hyjnë në Zelandë të Re nga 13 marsi, ka thënë

kryeministrja e këtij vendi, Jacinda Ardern.

Ata duhen të vetizolohen për 10 ditë, mirëpo programi shtetëror i karantinës do të anulohet.

Shtetasit e Zelandës së Re që kanë mbetur nëpër vende të ndryshme të botës, e kanë mirëpritur këtë lajm.

Ky njoftim ka ardhur pas rritjes së kritikave për politikën

kontroverze të Zelandës së Re për mbyllje të kufijve, me qëllim të luftimit të pandemisë.

Kufijtë e këtij vendi kanë qenë të mbyllur për gati dy vjet.

Përgjatë asaj periudhe, ky shtet, me pesë milionë banorë, ka regjistruar 54 viktima dhe rreth 17 000 raste të infektimit - shifra shumë më të vogla sesa në pjesën tjetër të botës.





## Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi sot dalin para Gjykatës Speciale

PRISHTINË, 3 SHKURT - Ish-drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, sot (e premte) do të dalin para Gjykatës Speciale në Hagë, të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim pas konfirmimit të aktakuzës.

Konferenca për ecurinë e çështjes ndaj ish-liderëve të UÇK-së pritet të nisë në orën 14:30. Më 5 nëntor të 2020-s Dhomat e Specializuara kishin konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe ishin ftuar të paraqiten në gjykatë. Thaçi, Veseli dhe Selimi, pas marrjes së ftesës, vullnetarisht kishin udhëtuar për në Hagë. Në paraqitjen e tyre të parë para trupit gjykues, ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Deri më tani janë mbajtur disa konferenca statutorë me qëllim të organizimit të shkëmbimeve ndërmjet palëve. Fillimisht në këto seanca ish-komandantëve të UÇK-së u është lexuar aktakuza, ku ata kanë hedhur poshtë pretendimet e prokurorisë. Konferencat statutorë janë karakterizuar me

përplasje të avokatëve me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë së Specializuar. Pala mbrojtëse e ka akuzuar vazhdimisht prokurorinë për zvarritje të qëllimshme të procesit dhe mosdorëzim të dosjes paraprake. Kur ka kaluar më shumë se një vit, prokuroria ka dorëzuar dosjen paraprake në rastin ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u akuzuar për krime lufte nga Gjykata Speciale. Gjatë konferencave statutorë janë zhvilluar debate-akuza të ashpra në mes të avokatëve mbrojtës të ish-drejtuesve të UÇK-së dhe prokurorëve të Gjykatës Speciale.

Akuzat më të ashpra të avokatëve ndaj kësaj gjykatë janë thënë në seancën për ecurinë e çështjes, e cila është mbajtur më 29 tetor të vitit 2021. Në këtë seancë avokatët e ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë thënë se themelet e Gjykatës Speciale janë mbështetur mbi gënjeshtër.

Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka shpërthyer në akuza ndaj prokurorisë, duke theksuar se Specialja u ndërtua mbi themelet e një raportit (te Dick Marty) që është



krejtësisht gënjeshtër.

Akuzat ndaj Prokurorisë së Specializuar të Hagës i ka vazhduar edhe avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe. Ai ka thënë se prokuroria po bën veprime që shkojnë në dëm të krerëve të UÇK-së.

Kujtojmë se avokati i Thaçit, ai i Veselit, i Selimit dhe i Krasniqit disa

herë gjatë vitit 2021 kanë kërkuar nga Gjykata Speciale që klientët e tyre të mbrohen në liri, por një gjë e tillë është refuzuar në vazhdimësi. Në këtë drejtim avokatët kanë ofruar edhe garanci për klientët e tyre, por një gjë e tillë është refuzuar. Madje Gjykata Speciale nuk i ka marrë parasysh as garancitë që ka ofruar edhe Policia e Kosovës.

Gjatë muajit shtator të vitit 2021 një delegacion i Ministrisë së Drejtësisë ka vizituar të paraburgosurit në Hagë. Këtë delegacion kishin refuzuar ta takonin Thaçi dhe Veseli. Krahas këtyre vizitave, gjatë vitit të kaluar janë lejuar edhe vizitat familjare dhe të miqve të ish-liderëve të UÇK-së.

## Rama: Çmimi i naftës është rritur kudo, por do të vazhdojmë me rritjen e pagave



Tiranë, 3 shkurt - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar për rritjen e çmimit të naftës, benzines dhe gazit. Ai ka replikuar me një qytetar përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", pasi donte të dinte arsyen përse qeveria duhet të vendosë një çmim të lartë, ndërsa Shqipëria është vendi më i varfër në rajon. Në përgjigjen e


tij, Rama i ka thënë se rritja e çmimit të naftës nuk është problem vetëm i Shqipërisë, ndërsa për pagat ka theksuar se do të ketë sërish rritje. "Rritja e çmimeve është një problem i përgjithshëm sot. Mjafton të shihni Kosovën për të mos shkuar me larg, ndërkohë që, siç kam premtuar, ne po mbajmë më shumë kosto për buxhetin,

mburojën mbi çmimin e energjisë për konsumatorët familjarë e biznesin e vogël, që kudo ka kërcyer e po kërcen lart! Sa për rrogat, ato janë rritur e do të vazhdojnë të rriten, por rritja e rrogave nuk bëhet sipas dëshirës sonë, pasi unë i pari do të doja t'i rrisja menjëherë të gjitha, por çdo rritje jashtë mundësive, do të thotë falimentim total në pak

muajsi në kohën e Sudës, prandaj duhet punë dhe durim, për t'u ngjitur me këmbë në tokë. S'ka asnjë rrugë tjetër të sigurt", i është përgjigjur kryeministri Rama. Nafta së fundmi duket se po i afrohet nivelit të 200 lekëve për litër. Në disa pika të karburanteve në kryeqytet nafta shitet për 193 lekë, duke u shtrenjtuar me gati 8 lekë në raport me rritjet e fundit.

Rritja ka vijuar edhe për benzinën. Aktualisht në pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve benzina tregtohet për rreth 195 lekë për litër duke shënuar një shtrenjtim të ngjashëm me naftën, teksa nuk ka ndalur shtrenjtimin as çmimi i gazit. Ky i fundit në disa karburante shitet për rreth 94 lekë për litër.





KOMITETI PËR KOORDINIMIN DHE VLERËSIMIN E SITUATËS ME PANDEMINË COVID-19  
KA DHËNË REKOMANDIMET E TIJ

# Propozohet lehtësime i masave kundër Covidit

Qeveria e Kosovës sot (e premte) pritet të marrë vendim për lehtësimin e masave kundër Covidit. Një gjë të tillë e ka propozuar komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës me pandeminë Covid-19 në vend. Masat e reja përfshijnë shtyrjen e orës policore deri në orën 24:00 dhe zgjatjen e orarit të punës për gastronominë deri në orën 23:00. Në ditën e propozimit për zbutje të masave, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se varianti Omicron i koronavirusit vazhdon të përhapet me intensitet të lartë në vend.

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës me pandeminë Covid-19 në vend ka rekomanduar lehtësimin e masave kundër Covidit. Masat e reja që pritet të miratohen sot (e premte) në mbledhjen e qeverisë përfshijnë shtyrjen e orës policore deri në orën 24:00 dhe zgjatjen e orarit të punës për gastronominë deri në orën 23:00. Ndërsa qytetarët që hyjnë në Kosovë dhe kanë dy doza të vaksinës kundër Covidit më nuk kanë nevojë për test

negativ PCR.

Pas mbledhjes së komitetit, ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, masat shtrënguese i ka vlerësuar të suksesshme. “Masat kanë treguar efekt shumë të mirë. Kështu që ne do t’i lehtësojmë shumicën prej këtyre masave. Ne i kemi propozuar sepse qeveria duhet t’i aprovojë. Hyrja në kufi do të jetë nëse i ka dikush të dyja vaksinat. Nëse e ka vetëm, një duhet të ketë test. Ora policore është shtyrë deri në 12:00 të natës dhe fitneset do të hapen”, ka thënë ai, duke shtuar se gjendja epidemiologjike në vend do të monitorohet në

vazhdimësi. “Në bazë të të dhënave që kemi, jemi në gjendje t’i shkurtojmë masat. Nëse duhet, do t’i shtrëngojmë prapë. Krejt varet prej asaj çka ngjan me statusin epidemiologjik në Kosovë. Besoj se këto miratohen nesër dhe nëse ka nevojë i ndërrojmë brenda natës”, ka thënë ai.

**Omicroni vazhdon të përhapet me intensitet të lartë**

Në ditën që komiteti ka propozuar lehtësim të masave, Instituti Kombëtar i

Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se varianti Omicron i koronavirusit vazhdon të përhapet me intensitet të lartë në vend. “Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik, andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të testohen”, ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij instituti, situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë në ditët në vazhdim. “IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët

që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa u rekomandojmë institucioneve përgjegjëse t’i mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoret maska, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtëjme të infeksionit të Covid-19. “Omicroni është tejet ngjitës, andaj mbani maskën në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po që se të



# Aeroporti i Gjakovës, në listën e premtimeve të papërbushura

PRISHTINË, 3 SHKURT - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është ndër më të ngarkuarit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas Këshillit Ndërkombëtar të Aeroporteve në Evropë (ACI), Aeroporti "Adem Jashari", në vitin 2021, u ka shërbyer mbi 2.1 milionë pasagjerëve.

Nga vendet e rajonit, vetëm Aeroporti i Beogradit ka pasur më shumë se 3.2 milionë pasagjerë.

Me shifrat e regjistruara, Aeroporti i Prishtinës ka hyrë për herë të parë në mesin e 100 aeroporteve më të ngarkuara në Evropë, sipas ACI-së. Sipas zyrave statistikore në Ballkan, Kosova në vitin 2021 ka shënuar rënien më të vogël të trafikut të pasagjerëve ajrorë krahasuar me periudhën para pandemisë: vetëm 8 për qind.

Rënien më të madhe e kanë pësuar Kroacia (59 për qind) dhe Mali i Zi (50 për qind).

Aeroporti "Adem Jashari" është i vetmi që shfrytëzohet në Kosovë për qëllime civile, edhe pse vendi ka edhe Aeroportin e Gjakovës i cili ndodhet rreth 90 kilometra larg Prishtinës.

Premtimet e dhëna nga partia tani në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje - se ky aeroport do të shërbejë për udhëtime me kosto më të lirë, nuk duket se janë duke u materializuar. "Aeroporti i Gjakovës do të funksionalizohet me dy shërbime bazë: kargo [bartje e mallrave] dhe udhëtime me kosto të ulët", është thënë në programin zgjedhor të Vetëvendosjes në fillim të vitit 2021. Por, në programin katërvjeçar të qeverisë së formuar nga kjo parti, në mars të vitit të kaluar, nuk përmendet asnjë plan për Aeroportin e Gjakovës.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës nuk u janë përgjigjur pyetjeve të "Radion Evropa e Lirë" për këtë çështje.

Aeroporti i Gjakovës, pas luftës së viteve 1998/99, është rindërtuar nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, përkatësisht nga paqeruajtësit italianë.

Deri në vitin 2013 ai është përdorur për mbështetjen e aktiviteteve ushtarake të misionit të NATO-s. Në dhjetor të atij viti, pas një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet qeverive të atëhershme të Italisë dhe Kosovës, Aeroporti i Gjakovës me të gjitha mjetet për operim është transferuar tek autoritetet e Kosovës.

Gjashtë vjet më vonë, me një vendim të Qeverisë së Kosovës,



aeroporti i është dhënë në shërbim Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Forcës së Sigurisë së Kosovës. Nga Ministria e Mbrojtjes konfirmojnë për "Radion Evropa e Lirë" se "hapësirat e Aeroportit të Gjakovës përdoren për nevojat e FSK-së" dhe thonë se investimet e fundit, të bëra atje, lidhen me "ngritjen e rrethojave të aeroportit" dhe "sigurimin e hapësirave të aeroportit".

Sa iu përket premtimeve të Lëvizjes Vetëvendosje për funksionalizimin e aeroportit për shërbime civile, në Ministrinë e Mbrojtjes nuk japin detaje, por thonë se kjo "varet nga strategjia dhe planet zhvillimore të Qeverisë së Kosovës".

Që Aeroporti i Gjakovës t'u u vihet në dispozicion shërbimeve civile, Qeveria e Kosovës duhet ta shfuqizojë fillimisht vendimin e vitit 2019, thotë ish-ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Rrustem Berisha, duke iu referuar vitit kur aeroporti i është dhënë në shfrytëzim FSK-së. "Duhet të bëhet një analizë për të parë nëse është më i nevojshëm për shërbime ushtarake - pasi ne synojmë të jemi pjesë e NATO-s - apo të bëhet aeroport për shërbime civile", thotë Berisha, duke theksuar se aeroporti mund të shërbejë për të dyja qëllimet.

## A mund të hapet aeroporti i dytë në Kosovë?

Megjithatë, hapja e një aeroporti të dytë civil në Kosovë mund të jetë vështirë e realizueshme, së paku edhe për një kohë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës në vitin 2010 i është dhënë në shfrytëzim një konsorciumi turko-francez për një periudhë 20-vjeçare.

Kontrata midis autoriteteve të Kosovës dhe konsorciumit "Limak & Aeroport de Lyon", neni 13.6, e siguron këtë të fundit se nuk do t'i nënshtrohet konkurrencës së drejtpërdrejtë me hapjen e një aeroporti tjetër komercial në Kosovë.

Nëse një aeroport i tillë hapet, Qeveria e Kosovës obligohet ta sigurojë konsorciumin në fjalë se nuk do të ketë humbje nga një kompani ndërkombëtare, që potencialisht do të operonte në Kosovë.

I pyetur nëse Kosova ka nevojë për një aeroport tjetër civil, drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Bujar Ejupi, shprehet i rezervuar në përgjigje. "Nëse vendoset të hapet, ne e kryejmë procesin e certifikimit", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Ali Aliu, njohës i çështjeve të

aviacionit civil, thotë se Kosovës, me 1.8 milion banorë dhe me diasporën e saj, i mjafton vetëm një aeroport ndërkombëtar. Sipas tij, Aeroporti i Shkupit në Maqedoni të Veriut dhe ai i Kukësit në Shqipëri mund të jenë aeroporte alternative për udhëtarët.

Dy aeroportet ndodhen rreth 115 kilometra larg Prishtinës, edhe pse i Kukësit aktualisht është jashtë funksionit, për shkak të, siç është thënë, mungesës së pasagjerëve.

Aliu thotë se Aeroporti i Gjakovës mund të shërbejë për udhëtime turistike, biznesi apo edhe të bëhet akademi për shkollimin e kuadrove të reja për pilotim dhe shërbime të tjera të aviacionit. "Me pak investime, Aeroporti i Gjakovës shumë lehtë funksionalizohet, pasi që pista është në rregull, është pak e ngushtë, por mund të zgjerohet dhe mund të shfrytëzohet. Është pothuajse i gatshëm nga investimet që ka bërë KFOR-i italian", thotë Aliu për "Radion Evropa e Lirë".

Në vitin 2012 kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar hapjen e një "akademie të rëndësishme të fluturimit" që, sipas tij, do të operonte në Aeroportin e Gjakovës, por një gjë e tillë nuk është realizuar. Aeroporti i Gjakovës gjendet rreth 5 kilometra në veri të qytetit të

Gjakovës. Është i vendosur në një hapësirë relativisht të rrafshët - rreth 400 metra mbi nivelin e detit. Në vitin 2017 ngjashëm ka premtuar edhe kryeministri i atëhershëm, Isa Mustafa, por as ai premtim nuk është përbushur. Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës i ka bërë atij një auditim në vitin 2016.

Në mesin e përfundimeve të nxjerra është se në këtë aeroport është instaluar kulla mobile e kontrollit të trafikut ajror, e pajisur me sistemet e nevojshme të komunikimit tokë-ajër; aeroporti ka edhe infrastrukturën e furnizimit me rymë dhe ujë dhe mjetet për furnizimin e aeroplanëve me karburante.

Aeroporti ka një sistem të vetëm piste me një rrugë paralele për taksim. Pista është 1 799 metra e gjatë dhe 30 metra e gjerë.

Terminali i aeroportit përbëhet nga hapësirat e terminalit të udhëtarëve dhe mallrave, parkingu i aeroplanëve, hapësirat për ngarkim dhe shkarkim dhe hapësirat për shërbime të udhëtarëve.

Aeroporti i Gjakovës është formuar dhe funksionalizuar që pas Luftës së Dytë Botërore për nevoja të agrokulturës. Në vitet '90 ai ka pushuar së funksionuari deri në kohën kur është marrë nga KFOR-i.

gjihtë bartin maska. Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19,

veçanërisht formave të rënda të sëmundjes dhe vdekjeve, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të

popullatës nga mosha 12-vjeçare. Vaksinat mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor në komunën tuaj. Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Pesë të vdekur dhe mbi 2 000 raste të reja

Në ditën që është propozuar zbutja e masave, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur pesë persona nga Covidi dhe janë shënuar mbi 2 000 raste të reja të infektimit. "Në 24 orët e

fundit janë dhënë 3 037 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 786 709 doza të vaksinës. Deri më sot 806 884 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 84 819 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Nga 9

451 testime, 2 110 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 5 raste të vdekjes. Sot janë shëruar 3 772 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 178 768. Në total numri i rasteve aktive është 30 871", ka njoftuar MSh-ja.



## Kryetari Latifi pret në takim qytetarët, dëgjon brengat e tyre

**RAHOVEC, 3 SHKURT (ER)** - Edhe këtë të enjte kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur

takime me qytetarë. “Këto takime realizohen ‘sy më sy’ me kryetarin, ku qytetarët i shprehin para tij

brengat e tyre. Kërkesat e qytetarëve kryetari i pranon me shumë sinqeritet duke u ofruar

atyre zgjidhje në kuadër të kapaciteteve që ka komuna”, ka njoftuar kryetari i komunës së Rahovecit.



## Funksionimi i mirë i qeverisjes lokale, i domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) ka organizuar punëtorinë me temë “Ndryshimet në legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë”. Pjesëmarrës ishin kryesuesit e grupeve të këshilltarëve të kuvendeve komunale në regjionin e Prishtinës (Prishtinë, Glogoc, Podujevë, Lipjan, Fushë-Kosovë, Graçanicë).

Qëllimi i takimit ishte diskutimi në lidhje me ndryshimet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe familjarizimi i anëtarëve të ri me legjislacionin bazë të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në vitin 2021 ka bërë ndryshime në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale me anë të të cilave synohet të avancohet funksionimi i qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Në këtë punëtori u tha se funksionimi i mirë i qeverisjes lokale është i domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve efikase dhe efektive për qytetarët dhe për forcimin e



demokracisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. “Funksionimi efikas i komunave është parakusht i zhvillimit të qëndrueshëm, rrjedhimisht institucionet lokale janë kontakti i parë dhe më i afërt ku qytetarët marrin shërbimet e

nevojshme për ta”, thanë pjesëmarrësit në këtë punëtori. Ky takim ishte në kuadër të përkrahjes së Institutit KLGJ për komunat dhe institucionet qendrore për hartimin e politikave të reja në fushën e qeverisjes lokale. Ky takim do të vazhdojë edhe të premten ku do

të diskutohet për politikat e reja që janë hartuar në fushën e qeverisjes lokale.

Instituti KLGJ u është përkushtuar analizave dhe studimeve që i kontribuojnë praktikave efektive të qeverisjes lokale në Kosovë. Po ashtu, KLGJ nëpërmjet programeve

edukative punon për ngritjen e kapaciteteve të komunave të vendit.

Aktiviteti u realizua në kuadrin e programit ‘Dialogu për Komunitet Evropian’ (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

## Hamza pret në takim një delegacion nga Këshilli i Evropës



**MITROVICË, 3 SHKURT (ER)** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit nga programi i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian-ROMACTED, Tankut Soykan dhe bashkëpunëtorët e tij, Besim Shkololli dhe Sakibe Jashari.

Në këtë takim, më tepër informues, u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit në mes të komunës së Mitrovicës dhe ROMACTED, duke përfshirë realizimin e projekteve të cilat kanë për qëllim gjithëpërfshirjen

dhe fuqizimin e komunitetit romë në Mitrovicë.

Gjatë këtij takimi është bërë me dije se në muajt në vijim do të nënshkruhet edhe një memorandum i bashkëpunimit për realizimin e fazës së dytë të projektit i cili promovon qeverisjen e mirë dhe synon fuqizimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptas. Me këtë rast, kryetari Hamza ka falënderuar përfaqësuesit nga ROMACTED për bashkëpunimin e vazhdueshëm duke u shprehur se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Komuna e Vushtrrisë pranon donacion karrocë elektrike nga OJQ “Liria”

**VUSHTRRI, 3 SHKURT (ER)** - Komuna e Vushtrrisë ka pranuar donacion një karrocë elektrike nga OJQ

“Liria”. Me këtë rast kryetari i komunës, Ferit Idrizi, ka pritur në takim Xhafer Balaj nga OJQ

“Liria”. Në praninë e kryetarit Idrizi dhe Balaj kjo karrocë iu dorëzua përfituesit Ali Zeqiri.

Kryetari Idrizi ka falënderuar Xhafer Balajn për donacionin dhënë komunës së Vushtrrisë.





# Krasniqi: PDK-ja do të jetë nxitëse e reformave në legjislacionin për zgjedhjet në Kosovë



PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në takim eurodeputetin austriak Lukas Mandl. Krasniqi ka thënë se përtej kultivimit të raporteve

Austri - Kosovë, për çka ai është angazhuar një kohë të gjatë, si udhëheqës i Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve lokale në Kosovë nga Bashkimi Evropian të enjten i ka dorëzuar raportin për monitorimin e zgjedhjeve

të fundit lokale në Kosovë. "Z. Mandl si kryevëzhgues, bashkë me ekipin tij, i falënderova për punën e jashtëzakonshme gjatë periudhës zgjedhore në vendin tonë. Më vjen mirë që Kosova vazhdon të jetë shembull i

organizimit të zgjedhjeve në rajon dhe më gjerë. Gjatë këtij takimi e sigurova z. Mandl se PDK-ja, si lidere e opozitës, do ta japë kontributin për të shtyrë përpara implementimin e rekomandimeve të dala nga

raporti i monitorimit të zgjedhjeve nga misioni vëzhgues i Bashkimit Evropian. PDK-ja do të jetë nxitëse e reformave të nevojshme në legjislacionin për zgjedhjet në Kosovë", ka thënë Krasniqi.

# RoAiad i dhuron donacion ShSKUK-së pajisje mjekësore dhe material shpenzues

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 SHKURT - RoAiad, një agjenci brenda Qeverisë së Rumanisë, përmes Zyrës Ndërlidhëse të Rumanisë në Kosovë, i dhuroi Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës një donacion me pajisje mjekësore dhe material shpenzues.

Donacioni kap vlerën e 20 mijë eurove, ndërsa përfituese është Klinika e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka falënderuar shtetin rumun për ndihmën e ofruar, duke thënë se ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët, në këtë rast për fëmijët që kërkojnë trajtim në Klinikën e Pediatriisë. Sipas tij, donacioni ka rëndësi të veçantë, sepse shpreh miqësinë dhe solidaritetin mes popujve, sidomos në kohë të vështira.

Drejtori Krasniqi e siguroi udhëheqësin e Zyrës Ndërlidhëse të Rumanisë në

Kosovë, Daniel Onisor, se donacioni do të përdoret për qëllimin e destinuar.

Ndërkaq, Onisor tha se ky donacion është një ndihmë nga populli rumun, dedikuar për Pediatriinë. Gjatë ceremonisë së dorëzimit-pranimit të donacionit, i pranishëm ishte edhe zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, i cili falënderoi shtetin e Rumanisë, derisa theksoi nevojën e vazhdimin të bashkëpunimit mes dy shteteve në fushën e shëndetësisë.



# Vlerësohet mbështetja e NALT-it për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në



PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Me qëllim të koordinimit të përpjekjeve këshillimore, të enjten është mbajtur takimi i lidërshiptit të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT). Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka theksuar se ky takim ruan kohezionin e koordinimit të suksesshëm të aktiviteteve që mundësojnë realizimin me sukses të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes. Ai e vlerësoi mbështetjen e NALT-it si të një rëndësie të madhe në të gjitha të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-

së, dhe për këtë ka falënderuar dhe ka shprehur mirënjohjen e lartë për drejtorin e NALT-it, gjeneralbrigade Jorg Ruter dhe ekipin e tij.

Drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Jorg Ruter, vlerësoi lart takimin e sotëm si një mundësi e mirë për të vlerësuar dhe diskutuar aktivitetet e realizuara deri më tani dhe aktivitetet e planifikuara për të ardhmen. Në vijim, gjenerali Ruter ftoi ekspertët nga Bullgaria, dr. Velizar Shalamanov dhe Irena Mladenova, që të bëjnë një prezantim përmes videolinkut mbi menaxhimin e ndryshimeve organizative në administratën shtetërore.

# Kryetari i Malishevës çdo të enjte pret në takim qytetarët

MALISHEVË, 3 SHKURT (ER) - Dita e enjte do të jetë ditë takimi i qytetarëve me kryetarin e komunës së Malishevës, Ekrem

Kastrati. Kështu ka njoftuar zyra për informim e kësaj komune. "Njoftohen të gjithë qytetarët e komunës së Malishevës, se

kryetari Ekrem Kastrati do të mbajë dyert e hapura për pritjen e qytetarëve dhe këtë do ta bëjë çdo ditë të enjte, duke filluar nga

ora 13:00 deri në orën 15:00. Takimet mbahen në zyrën e kryetarit të komunës", ka njoftuar komuna e Malishevës.





## Nënshkruhet marrëveshja “Aftësitë për tregun e punës - Fit for jobs”

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, drejtori i GIZ-it në Kosovë, David Oberhuber dhe udhëheqësi i projektit, Tobias Seiberlich, kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen e implementimit për projektin “Aftësitë për tregun e punës - Fit for jobs”. Projekti që bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës dhe ajo gjermane synon rritjen e numrit të rinjve të punësuar në Kosovë përmes përmirësimit të arsimit dhe aftësitë profesionale, orientimit në karrierë dhe përmirësimit të qasjes së rinjve në shërbimet e tregut të punës. Përkatësisht, projekti “Fit for jobs” mbulon katër fusha kryesore, siç janë, orientimi sistematik në karrierë në

sistemin arsimor të mesëm të ulët, promovimi i përfshirjes sistematike të sektorit privat në arsim dhe aftësim profesional, zvogëlimi i hendekut në mes të arsimit profesional dhe kalimit në tregun e punës, si dhe orientimi në karrierë me anë të politikave dhe strategjive përkatëse. Në fushën e MFPT-së, bashkëpunimi synon angazhimin e praktikantëve në Agjencinë e Punësimit, angazhimin e trajnerëve sipas nevojave të Qendrave për Aftësim Profesional, zhvillimin e kapaciteteve të QAP-ave dhe implementimin e skemës së kuponëve të trajnimeve për punëkërkuarët. Gjatë fjalës së tij, ministri Murati ka vlerësuar lart bashkëpunimin në mes të palëve duke u shprehur se bashkëpunimi i ngushtë me qeverinë gjermane është shumë i rëndësishëm në



mënyrë që bashkërisht të krijojnë perspektiva më të mira përmes një pjesëmarrje aktive

në tregun e punës në vend. Palët u zotuan që ta vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet dy

qeverive për arritjen e qëllimeve për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

## Agrokosova Holding do të jetë nën administrimin e AKP-së



PRISHTINË, 3 SHKURT - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka marrë vendim për tërheqje të aksioneve dhe vendosje nën administrim të drejtpërdrejtë të ndërmarrjes së re Agrokosova Holding (ish-Ndërmarrja Shoqërore “NBI Suhareka”). Agjencia Kosovare e Privatizimit, pas përfundimit të procedurave të nevojshme me rastin e tërheqjes së aksioneve të enjten, ka ekzekutuar vendosjen e ndërmarrjes së re Agrokosova Holding (ish-NBI Suhareka), e cila tani e tutje do të jetë nën administrimin të drejtpërdrejtë të AKP-së. “Me këtë rast, Agjencia Kosovare e Privatizimit u bënë thirrje të gjithë punëtorëve aktualë, të të gjitha profileve, të cilët kanë


marrëdhënie pune në ndërmarrjen e re Agrokosova Holding, ta vazhdojnë punën dhe të mos largohen nga vendet e punës. Po ashtu, ftohen të gjithë bujqit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me Agrokosovën ta vazhdojnë punën. AKP zotohet se do të vazhdojë bashkëpunimi me qëllim të mbarëvajtjes së marrëdhënieve komerciale dhe zhvillimit ekonomik të komunës së Suharekës”, ka njoftuar AKP-ja, duke shtuar se do të bëjë përpjekje për të ofruar zgjidhjen më të mirë për ndërmarrjen e re Agrokosova Holding (ish-NBI Suhareka). “Në ndërkohë, AKP-ja do ta vazhdojë aktivitetin e ndërmarrjes me punëtorët aktualë të cilët do të lidhin marrëdhënie pune me AKP-në”, ka njoftuar AKP-ja.

## Ambasada e Britanisë mirëpret vendimin për emërimin e bordit të KEK-ut

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë ka mirëpritur vendimin e qeverisë për emërimin e Bordit të Drejtorëve të Korporatës Energjetike (KEK). Sipas kësaj ambasade, kandidatët e emëruar janë rekomanduar nga ekspertët

britanikë. “Mirëpresim vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe urojmë të sapoemëruarit e Bordit të Drejtorëve të KEK-ut. Procesi i rekrutimit është mbështetur nga Projekti i Rekrutimit dhe kandidatët e emëruar janë rekomanduar nga ekspertët britanikë”, thuhet në

njoftimin për media. Për bordin e KEK-ut kanë aplikuar 72 kandidatë. Skënder Haziri është emëruar kryesues i bordit; Merita Kasapolli, anëtare; Berzat Halili, anëtar; Valbona Raifi-Deshishku, anëtare; Mustafa Pllana, anëtar dhe Valdrin Krasniqi, anëtar.





# Në lojë nuk është vetëm Ukraina, Putin dëshiron ta dëbojë SHBA-në nga e gjithë Evropa

Nga Fiona HILL  
"New York Times"

Ne e dinim që do të mbërrinim një ditë në një situatë të tillë. "George, duhet ta kuptosh se Ukraina nuk është tamam një shtet. Një pjesë e territorit të saj ndodhet në Evropën Lindore, dhe pjesa më e madhe na është dhënë neve". Këto ishin fjalët ogurzeza të presidentit Vladimir Putin të Rosisë në prillin e vitit 2008, drejtuar presidentit të atëhershëm të SHBA-së, George W. Bush në kryeqytetin rumun Bukuresht, gjatë një samiti të NATO-s.

Putin ishte dukshëm i zemëruar: NATO sapo kishte njoftuar se Ukraina dhe Gjeorgjia do të anëtarësoheshin një ditë në aleancë. Ajo ishte një formulë kompromisi për të zbutur shqetësimet e aleatëve tanë evropianë, pra një premtim i qartë për t'u bashkuar me bllokun, por jo një afat kohor specifik se kur do të ndodhë ky akt.

Në atë kohë, unë isha një oficer dhe shërbimit sekret për Rusinë dhe Euroazinë, si dhe pjesë e një ekipi që e informonte rregullisht zotin Bush. Ne e paralajmëruam presidentin se zoti Putin, do t'i konsideronte hapat për të afruar më pranë NATO-s Ukrainën dhe Gjeorgjinë si një lëvizje provokuese, e cila kishte të ngjarë të provokonte një veprim ushtarak parandalues nga ana e Rosisë.

Por në fund, paralajmërimet tona nuk u morën parasysh. Brenda 4 muajsh, në gushtin e vitit 2008, Rusia e pushtoi Gjeorgjinë. Dhe Ukraina e mori më zë të lartë dhe të qartë mesazhin e Rosisë. Ai sulm e vonoi anëtarësimin në NATO përgjatë viteve që pasuan. Por në vitin 2014, Ukraina donte të nënshkruante një marrëveshje asociimi me Bashkimin Evropian, duke menduar se kjo mund të ishte një rrugë më e sigurt për t'u atashuar me Perëndimin. Moska goditi sërish, duke e akuzuar Ukrainën se po kërkonte një derë të pasme për t'u bërë pjesë e NATO-s.

Ajo aneksoi gadishullin e Krimesë dhe nisi një luftë të gjatë nëpërmjet separatistëve pro-rusë në rajonin juglindor ukrainas të Donbasit. Reagimet e dobëta të Perëndimit ndaj pushtimeve të vitit 2008 dhe 2014 e trimëruan jo pak Putinin.

Dhe këtë herë, qëllimi i tij është më i madh sesa vetëm mbyllja e "derës së hapur" të NATO-s ndaj Ukrainës, dhe përvetësimi i më shumë territoreve. Tani ai dëshiron që të dëbojë Shtetet e Bashkuara nga Evropa. Siç mund



të shprehej lideri i Krenlinit: "Mirupafshim Amerikë! Kujdes mos përplasesh tek dera gjatë daljes!". Siç unë e kam parë për më shumë se 2 dekada, kohë në të cilën kam vëzhguar dhe analizuar lëvizjeve të Putinit, veprimet e tij janë të qëllimshme, dhe zgjedhja e tij në këtë moment për të sulmuar Ukrainën dhe shantazhuar Evropën është shumë e qëllimshme. Ai ka një fiksion personal me historinë dhe përvjetorët.

Dhjetori i vitit 2021 shënoi 30 vjetorin e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, kur Rusia e humbi pozitën e saj dominuese në Evropë. Putin dëshiron që t'i shkaktojë Shteteve të Bashkuara të njëjtën shije të hidhur që provoi Rusia gjatë viteve 1990. Ai beson se Shtetet e Bashkuara aktualisht janë të zhytura në të njëjtat telashe si Rusia pas shembjes së Bashkimit Sovjetik: të dobësuar shumë nga brenda dhe në tërheqje në arenën globale. Po ashtu ai mendon se NATO nuk është gjë tjetër, veçse një zgjatim i SHBA-së.

Zyrtarët dhe analistët rusë, mohojnë vazhdimisht çdo agjenci apo mendim të pavarur strategjik mbi anëtarët e tjerë të NATO-s. Pra, kur flitet për këtë të fundit, të gjitha lëvizjet e Moskës janë të drejtuara kundër Uashingtonit.

Gjatë viteve 1990, Shtetet e Bashkuara dhe NATO e detyruan Rusinë që të tërhiqte ato që kishin

mbetur nga ushtria sovjetike nga bazat e tyre në Evropën Lindore, Gjermani dhe shtetet baltike. Tani Putin dëshiron që Shtetet e Bashkuara të vuajnë në një mënyrë të ngjashme.

Nga këndvështrimi i Rosisë, vuajtjet e brendshme të Amerikës pas 4 viteve të presidencës katastrofike të presidentit Donald Trump, si dhe përçarjet që krijoi ky i fundit me aleatët e SHBA-së, dhe më pas tërheqja e shpejtë e Amerikës nga Afganistani, sinjalizojnë dobësinë e kësaj të fundit.

Në rast se Rusia ushtron një presion të mjaftueshëm, Vladimir Putin shpreson se ai mund të arrijë një marrëveshje të re sigurie me NATO-n dhe Evropën, për të shmangur një konflikt të pafund, dhe më pas do të jetë radha e Amerikës që të largohet nga kontinenti evropian, duke marrë me vete trupat dhe raketat e saj. Ukraina është edhe një objektivi i Rosisë, por njëherazi edhe një burim presioni kundër Shteteve të Bashkuara. Gjatë muajve të fundit, Putin e ka tërhequr administratën Biden në lojëra taktike të pafundme, që e vendosin SHBA-në në pozita mbrojtëse.

Rusia zhvendos forcat në kufijtë e Ukrainës, nis stërvitjet ushtarake dhe e forcon retorikën agresive brenda vendit. Në dokumentet e fundit zyrtare që ia ka paraqitur Uashingtonit, ajo kërkoi garanci të forta se Ukraina (dhe ish-republikat e tjera të BRSS) nuk do të bëhen kurrë anëtare të NATO-s,

që NATO të tërhiqet nga pozicionet që ka marrë pas vitit 1997, dhe që Amerika të tërheqë forcat dhe armët e veta, përfshirë raketat bërthamore.

Përfaqësuesit rusë thonë se Moska "nuk ka nevojë për një paqe me çdo kusht" në Evropë. Madje disa politikanë rusë sugjerojnë mundësinë e një sulmi parandalues kundër objektivave të NATO-s, për t'u siguruar që Perëndimit ta dijë se kërkesat e Moskës janë serioze dhe se ato duhet të përmbushen.

Për javë të tëra, zyrtarët amerikanë janë përpjekur të kuptojnë kërkesat e Rosisë dhe komentet e saj kontradiktore, dhe të gjejnë një mënyrë për ta penguar Putinin të mos mësyjë në Ukrainë. Ndërkohë gjatë gjithë kohës, Putin dhe përfaqësuesit e tij i kanë forcuar deklaratat e tyre.

Zyrtarët e Kremlinit kanë sfiduar jo vetëm legjitimitetin e pozitës së SHBA-së në Evropë, por kanë ngritur pikëpyetje në lidhje me bazat e Amerikës në Japoni dhe rolin e saj në rajonin e Azi-Paqësorit. Po ashtu, ata kanë thënë se mund të dërgojnë raketa hipersonike në Kubë dhe Venezuelë, për të ringjallur atë që rusët e quajnë "Kriza e Karaibeve" e viteve 1960.

Putin është një mjeshtër i shantazheve të tilla. Ai e prodhon një krizë në mënyrë të atillë që të mund t'i japë mundësinë të fitojë, pavarësisht se kë ka përballë. Kërcënimet dhe premtimet janë në thelb e njëjta gjë. Putin mund ta

pushtojë përsëri Ukrainën, ose mund t'i lërë gjërat aty ku janë, dhe të konsolidojë kontrollin në territorin që kontrollojnë aktualisht në Krime dhe Donbas.


Ai mund të shkaktojë probleme në Japoni, dhe të dërgojë ose raketat hipersonike në Kubë dhe Venezuelë, ose të mos e bëjë këtë nëse gjërat në Evropë shkojnë siç duhet. Putin luan një lojë më të gjatë, strategjike, dhe disi të dominojë në përplasjet taktike.

Tani për tani, të gjitha shenjat tregojnë se Putin do ta tërheqë SHBA-në në një lojë taktike të pafundme, do të marrë më shumë territore nga Ukraina, dhe do të shfrytëzojë të gjitha fërkimet dhe përçarjet brenda NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Dalja nga kriza aktuale kërkon veprim, dhe jo reagim.

Shtetet e Bashkuara duhet të diktojnë përgjigjen diplomatike, dhe ta angazhohen me Rusinë sipas kushteve të Perëndimit, dhe jo vetëm të Moskës. Uashingtoni duhet t'i tregojnë Putinit se ai do të përballlet me rezistencën globale, dhe se agresioni i tij do t'i rrezikojë marrëdhëniet politike dhe ekonomike të Rosisë përtej Evropës.

Formimi i një fronti të bashkuar me aleatët e saj evropianë dhe mbledhja e mbështetjes më të gjerë duhet të jetë loja më e gjatë e Amerikës. Përndryshe, kjo sagë mund të shënojë me të vërtetë fillimin e fundit të pranisë ushtarake të Amerikës në Evropë. *Marrë me shkurtime./Bota.al*





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Cana, krenar me Strakoshën, lavdëron edhe Hysajn

**ROMË, 3 SHKURT** - Ish-kapiteni i kombëtares së Shqipërisë dhe ish-mesfushori i Lazios, Lorik Cana, ka folur për skuadrën e Lazios, në veçanti për futbollistët shqiptarë që luajnë aty, por edhe për tema të tjera. Në një prononcim për radion e klubit, ish-kapiteni i kombëtares u fokusua te protagonistët e ekipit të Sarrit. "Hysaj është ambientuar mirë, e kam parë në hapat e tij të parë në Serinë A kur ishte tek Empoli dhe më pas te Napoli, ku bëri një rrugëtim të rëndësishëm. Ai është një djalosh që ka përvojë. Ka

arritur në momentin e duhur dhe trajneri Sarri e di se çfarë mund të marrë prej tij. Këtu te Lazio duhet të përpiqesh që të përmirësohesh, të japësh më të mirën nga vetja. Ai ka një performancë konstante dhe, për mendimin tim, ai gjithmonë është i gatshëm. Ai ka avantazhin që luan në të djathtë", ka thënë Cana, duke shtuar: "Tomas është rritur shumë, ai ka bërë një rrugëtim të jashtëzakonshëm. Nuk është e lehtë për një portier të ri të kalojë nga zgjedhje e tretë, në të parën. Tani ka mundësinë që të kthehet

protagonist, si një shqiptar që jam, jam shumë krenar për të". Në fund ish-mesfushori i spikatur i kombëtares kuqezi foli edhe për sulmuesin e Lazios, Ciro Immobile dhe Sergej Milinkoviç-Saviç. "Përtej admirimit dhe respektit për atë që ka bërë te Lazio. Mendoj që Immobile është më i miri i historisë së këtij klubi. Ai është lojtar i nivelit të lartë dhe vazhdon të kërkojë më shumë. Milinkoviç është një xhevahir. Nuk kam pasur mundësinë që të luajë me të, por ka bërë mrekulli", ka deklaruar Cana.



## Dabiqaj: Do të angazhohemi maksimalisht për t'i arritur objektivat

**GJILAN, 3 SHKURT** - Futbollit në Kosovë rikthehet këtë fundjavë me ndeshjet e Kupës së Kosovës në futboll. Ekipet tashmë veçse i kanë mbushur "bateritë" për stinorin pranveror. Sport Club "Gjilani" është një ndër skuadrat e cila ka qëndruar në Antalia të Turqisë ku ka kryer fazën përgatitore. Gjithashtu, "kuqebardhët" para se të udhëtonin drejt Turqisë kanë qenë për dhjetë ditë edhe në qytetin bregdetar të Durrësit. Gazeta



"Enigma" e ka kontaktuar njërin ndër mesfushorët më të mirë në Kosovë, Albert Dabiqajn, i cili ka folur për

atmosferën në klub dhe fazën përgatitore. "Atmosfera është shumë e mirë dhe e presim më shumë pozitivitet fillimin e stinorit pranveror", ka thënë Dabiqaj. Sipas numrit 14 të Gjilanit, faza përgatitore ka qenë shumë e suksesshme pasi që edhe nuk ka pasur lëndime të futbollistëve. "Kemi bërë një fazë përgatitore shumë të mirë në të dy vendet, Durrës të Shqipërisë dhe Antalia të Turqisë. Në Antalia kem pasur disa ndeshje kontrolluese me

ekipe shumë cilësore dhe jemi paraqitur shumë mirë. Rëndësi të madhe ka qe nuk kemi pësuar lëndime", ka shtuar mesfushori i Gjilanit. Futbollisti 25-vjeçar ka pasur një gjysmësezon të mrekullueshëm me gjilanasit, ku në 16 ndeshje ka arritur t'i realizojë katër gola dhe duke dhuruar një asistim. "Në përgjithësi kam kaluar një gjysmësezon shumë të mirë, por ajo mbetet në të kaluarën dhe se tani fillon stinori pranveror dhe fokusi i gjithë

grupit është këtu", ka deklaruar mesfushori. Për fund Dabiqaj ka edhe një mesazh për tifozët e flaktë, "Skifterat", të cilët po e përkrahin klubin vazhdimisht. "Tifozëve tanë u premtoj angazhim maksimal si gjithmonë drejt objektivave të klubit", ka përfunduar Dabiqaj. SC Gjilani është shpallur kampion vjeshtor dhe tashmë do të luftojë deri në fund të sezonit për t'u shpallur kampion për herë të parë në histori të klubit.

## Komuna e Mitrovicës rikthen në pronësi Qendrën Sportive 'Fatime Xhaka'



**MITROVICË, 3 SHKURT** - Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Prokurimit, Elvis Feka, të enjten kanë vizituar qendrën sportive "Fatime

Xhaka" në rrugën "Adem Voca" në Mitrovicë. Nga kjo vizitë ata kanë bërë me dije se nga e dita e enjte zyrtarisht komuna ka kthyer në pronësi të saj Qendrën Sportive "Fatime Xhaka" pas shkëputjes së

kontratës e cila ishte dhënë në shfrytëzim deri në vitin 2028. Drejtoresha Idrizi ka potencuar se Qendrës Sportive "Fatime Xhaka" do t'i rikthehet funksioni që e ka pasur më parë për t'i zhvilluar aktivitetet sportive, kulturore, si

dhe garat shkollore. Gjithashtu, u theksua se komuna e Mitrovicës brenda mundësive reale buxhetore dhe përmes donatorëve të ndryshëm së shpejti do ta fillojë renovimin e kësaj qendre sportive.

## FBK-ja konfirmon dorëheqjen e Rugovës

**PRISHTINË, 3 SHKURT** - Granit Rugova ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit të Përfaqësuesëve të Kosovës. Rugova e mori këtë detyrë më 15 gusht 2018, kur vendosi të pensionohet nga basketbolli aktiv dhe të punojë si drejtor i Përfaqësuesëve të Kosovës.

Rugova ka fituar shumë trofe me klubin e Sigal Prishtinës, derisa luajti edhe për Bashkimin, si dhe ishte pjesë e rëndësishme e Përfaqësuesës së Kosovës në garat ndërkombëtare. Ai përfundoi me sukses programin FIBA Time Out 2.0, ndërsa në dhjetor të vitit të kaluar u zgjodh

ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv në Ligën Unike. Për tre vjet e gjysmë sa ishte pjesë e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Graniti punoi me përkushtim e përgjegjësi, duke dhënë më të mirën e tij në punë dhe kjo i hapi dyert për suksese të tjera. Ish-basketbollisti i njohur

tashmë do të jetë drejtor në Departamentin e Sportit në komunën e Prishtinës, një pozitë shumë e rëndësishme për ta dhënë kontributin e tij për sportistët prishtinas. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, sekretarja e përgjithshme Elvira Dushku dhe Bordi i FBK-së e falënderojnë për kontributin e tij, duke i uruar shumë suksese në detyrën e re.





## Në Amerikë mund të shtohet edhe një garë e Formulës 1

**LAS VEGAS, 3 SHKURT** - Vitin tjetër mund të zhvillohen tri gara të Formulës 1 në Amerikë. Pas pistave të Austinit dhe Majemit, në kalendarin e garave për vitin 2023 pritet të jetë edhe një tjetër garë qytetase, ajo e Las Vegasit. Vendimi zyrtar pritet të

jepet në gjysmën e parë të këtij viti, ndërkohë që bisedimet mes Formulës 1 dhe Komisionit të Sportit në Nevada kanë kohë që kanë nisur. Në rast se gjërat nuk mbyllen brenda afateve të kërkuara nga FIA, atëherë gara e Las Vegasit do të jetë në

kalendarin e vitit 2024. Konfirmohet se bëhet fjalë për një garë qytetase, në rrugët e Las Vegasit, duke kaluar në disa nga zonat dhe kazinotë më të njohura të këtij qyteti. Një pistë që mund të jetë deri në 2km e gjatë. Drejtuesit e Formulës 1

kanë qenë disa herë në Las Vegas për t'i parë zonat e mundshme ku mund të "ndërtohet" një pistë qytetase. Në vitet 1981 dhe 1982 në këtë qytet janë zhvilluar dy gara, në zonën e parkimit të hotelit të famshëm "Caesars Palace".



## Lala: Duka si Hoenes, për sa kohë që ka energji duhet të vazhdojë

**TIRANË, 3 SHKURT** - Altin Lala ka dhënë së fundmi një intervistë për emisionin "Sport Magazine" në "Ora News". Legjenda e Kombëtares Shqiptare është shprehur se politika duhet të qëndrojë larg zgjedhjeve në FSHF dhe se ky diskutim në një vend të zhvilluar, as nuk çohet ndërmend. Gjithashtu, Lala theksoi se vitet në postin e FSHF nuk i ulin më tepër pikët Armand Dukës, përkundrazi vitet e fundit po flasin në favorin e tij me arritjet e futbollit shqiptar. "Sa herë ka zgjedhje në Shqipëri, ka edhe problematika, si në zgjedhje vendore dhe ato të FSHF-së. Nuk lë shije të mirë të futbollit. Në vendet e zhvilluara nuk ka lidhje fare politika dhe futbollit. Është inekzistente politika në futboll. Futbollin e ndjekin shumë njerëz, e shohin shumë, prandaj duan të përzihen edhe politikanët. Nuk është fare legjitime. Politikanët kanë shumë punë të tjera përpara se të



merren me sportin. Futbollit ka ecur shumë mirë. Armand Duka është menaxher shumë i mirë në tërësi. Duhet të jesh ekonomist dhe menaxher i mirë. Dikush mund të thotë se ka vite aty në post por, nga ana tjetër, ka bërë edhe punë të mirë. Kujt do t'ia merrte mendja para pesë vjetësh që do të zhvillohej një finale në Shqipëri?", ka thënë Lala. "Kjo është arritje e madhe për Shqipërinë. Politika duhet të

shtyjë përpara futbollin. Shpresoj se ardhja e Ceferin do të japë zgjidhje. Për sa kohë Duka ka energji dhe po vazhdon që të bëjë mirë, atëherë pse jo që të vazhdojë. Për shembull, te Bayern Muncheni është edhe Hoenes, një nga menaxherët më të mirë të futbollit. Ka qenë aty për 40 vjet, e dërgoi shumë lart Bayernin. Nuk dua të bëj krahasim, por paralelizëm ka në këtë pjesë", ka deklaruar Lala.

## Lakersat mposhtin Portlandin, vijon kriza për Brooklynin

**LOS ANXHELOS, 3 SHKURT** - Skuadra e Lakersat rikthehet te fitorja pas katër humbjeve radhazi, duke mundur me vështirësi me rezultat 99-94 Portlandin, dy ekipe që luftojnë për një vend në "play-off" në Perëndim. Sërish mungoi LeBron James, ndërkohë që dallimin në fushë e bëri Anthony Davis, me 30 pikë e 15 rebounde, mbështetur edhe nga Carmelo Anthony me 24 pikë. Vijon kriza e Brooklynit, që pësoi humbjen e



gjashtë radhazi në kampionat, duke zbritur në vendin e gjashtë në Lindje. Nets u mund me rezultat 112-101 nga Sacramento (7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë për vendasit). Fiton me vështirësi edhe Utah Jazzi, që mundi me rezultat 108-104 Denverin, dy ekipe që luftojnë për "play-off"-in. Vijon momenti i mirë për Memphisin,

që mundi 120-108 New Yorkun jashtë fushës. Për miqtë u dallua Jacksoni me 26 pikë e 10 rebounde. Luka Donçiqi realizoi 40 pikë e 10 asistime për Dallasin, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Dallasi u mund 120-114 pas kohës shtesë në shtëpi nga Sacramento (Dort 30 e Mann 29 pikë).

### Rezultatet

Indiana - Orlando	118-119
Philadelphia - Washington	103-106
Boston - Charlotte	113-107
New York - Memphis	108-120
Houston - Cleveland	115-104
Dallas - Oklahoma	114-120
Sacramento - Brooklyn	112-101
Utah Jazz - Denver	108-104
Lakers - Portland	99-94

## Aubameyangu: Synimi im është ta rikthej Barçën në Ligën e Kampionëve

Pierre-Emerick Aubameyang dëshiron ta udhëheqë Barcelonën drejt Ligës së Kampionëve, pasi iu bashkua gjigantit spanjoll në një marrëveshje trevjeçare e

gjysmë. Aubameyang nënshkroi marrëveshje me Barçën deri në vitin 2025 të mërkurën dhe e ka një klauzulë lirim në vlerë 100 milionë euro. Ai iu bashkua gjigantit

katalonas si lojtar i lirë, pasi e kishte shkëputur marrëveshjen me Arsenalin. Barcelona, e cila luan në Ligën e Evropës, këtë sezon ku do të përballet me Napolin, është në vendin e

pestë në tabelë në La Liga, një pikë mbropa vendit të katërt Atletico Madrid. "Jam shumë krenar, veçanërisht sepse familja ime nga ana e nënës është spanjolle. Jam shumë i

lumtur që jam këtu. Synimi im kryesor është ta ndihmoj ekipin dhe të jap gjithçka nga vetja për ta rikthyer Barcelonën në Ligën e Kampionëve e gjëra të tilla", ka thënë Aubameyang.

### SHKURT

#### Gikalleshi rinovon kontratën me Konyasporin

Sokol Gikalleshi u jep fund dilemave për të ardhmen e tij. Sulmuesi i kombëtares shqiptare ka rinovuar marrëveshjen edhe për dy vjet të tjera me klubin aktual, Konyaspori. Kontrata e tij me turqit skadonte në mbyllje të këtij sezoni por, pas negociatave, 31-vjeçari ka pranuar ofertën e re të Konyasporit me një rritje page, duke u bërë tashmë ndër më të shtrenjtët në ekip. Gikalleshi kishte lënë gjithçka pezull, pasi e tundonte një ofertë nga Japonia, gjithashtu edhe një klub arab.

#### Gullit: Bayerni duhet ta marrë De Ligtin, Haalandi i përkryer për Liverpoolin

Ruud Gullit, legjenda holandeze e Milanit, ka këshilluar Bayern Munchenin të marrë Matthijs de Ligt nga Juventus, ndërkohë që flet edhe për të ardhmen e Erling Haalandin në intervistën e dhënë për "Bild". "De Ligt ka mësuar shumë te Juventus dhe mund të japë një kontribut të madh për Bayern Munichun", ka thënë fillimisht holandezi, i cili më tej ka folur për sulmuesin norvegjez të Borussia Dortmundit. "Haaland e shoh në Angli, por mendoj se nuk do të shkojë te Manchester Unitedi. City do të ishte një opsion i mirë për shkak të Pep Guardiolas. Liverpooli dhe Jurgen Kloppi do të ishin një mrekulli për të. Ajo që ka bërë Jurgen në atë klub është e pabesueshme. Thjesht duhet ta duash atë dhe ai gjithmonë është i uritur. Kjo i shkon për shtat Haalandit. Në Spanjë vetëm Real Madridi është një opsion. Këto janë tri klubet që do të jenë në garë për Erlingun", ka deklaruar Gullit.

#### Tottenhami dhe Juve, në garë për Zaniolon

Tottenham Hotspuri dhe Juventus i në afatin kalimtar të verës po planifikojnë ta tentojnë transferimin e yllit të Romës, Nicolò Zaniolo. Sipas "Calciomercato", diskutimet për rinovimin e kontratës mes Zaniolos dhe Romës kanë ngecur dhe 24-vjeçari mund të largohet. Zaniolo ka edhe dy vjet e gjysmë të mbetur në kontratë, duke shënuar 18 herë dhe regjistruar 11 asistime në 95 paraqitje në të gjitha garat.

#### Berbatovi, kandidat zyrtar për kreun e Federatës Bullgare të Futbollit

Dimitar Berbatov është një nga emrat më të njohur në futbollin bullgar. Ai ka pasur një karrierë të lavdishme te Manchester Unitedi, Tottenhami dhe Bayer Leverkuseni, ndërkohë që ka shënuar 48 gola në 78 takime me kombëtaren bullgare. 41-vjeçari nuk mund të qëndrojë larg futbollit dhe ka vendosur të kandidojë për postin e presidentit të Federatës Bullgare të Futbollit. Emri i tij është propozuar nga CSKA Sofia, ekipi ku e nisi karrierën ish-sulmuesi. "Klubi ynë mbështet kandidaturën e Berbatovit. Duam ndryshimin dhe besojmë se është e nevojshme që kjo të ndodhë në mënyrë që futbollit bullgar të përparojë", lexohet në komunikatën e klubit kryeqytetas. Berbatov është golashënuesi më i mirë në historinë e kombëtares ballkanike, teksa është shpallur shtatë herë si futbollisti bullgar i vitit. Zgjedhjet për kreun e ri të futbollit bullgar do të mbahen në muajin mars.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Sidi Group" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811274208 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Sidi Group" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811274208, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Sidi Group" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811274208, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Rrodear SH.P.K. shpalle të pavlefshme certifikatat NUI: 810099425 dhe numri i TVSH-se : 330382044.

► Parim Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjtë e Lumes " Vermice.

► Zaim Fazli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Adil Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Sylejman Gjakmani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Taulant Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Jaser Faiku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Hilmi Bahtijari " Blaq Dragash.

► Rexhep Mehmeti, Zhebel KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Dëshmorët e Dushkajës" nga kl. I-V dhe VI-IX.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

